



Gjovalin Preçi

Kryeauditues

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Z. Gjovalin Preçi ka përfunduar studimet Universitare në Fakultetin Ekonomik në Degën e Planit në vitin 1985, si dhe studimet e nivelit "Master" në Universitetin Bujqësor të Kamzës, në profilin e Ekonomisë dhe Politikave Agrare në vitin 2005.

Nga viti 1986 deri në vitin 2006 ka kryer detyra të ndryshme në sektorin publik në nivel vendor dhe qendror, si Përgjegjës i Zyrës së Mbrojtjes Sociale, Kryespecialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Përgjegjës i Sektorit të Mbikëqyrjes në Inspektoratin e Mbikëqyrjes së Pensioneve Private pranë Këshillit të Ministrave etj.

Gjatë kësaj periudhe nuk kanë munguar angazhimet individuale në zbatimin e projekteve nga organizata të shoqërisë civile vendase dhe të huaja, si dhe me botime në revista shkencore e shtypin e përditshëm. Në Kontrollin e Lartë të Shtetit ka filluar punë në muajin shkurt të vitit 2007 në detyrën e Audituesit dhe më pas të Kryeaudituesit dhe Drejtorit në Departament Auditimi.


Gjatë eksperiencës në KLSH, z. Gjovalin Preçi është ngarkuar edhe me detyra të tjera si atë të Sekretarit të Përgjithshëm etj.


Aktualisht është i emëruar në pozicionin e "Kryeaudituesit" në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.


Gjatë kësaj eksperience të gjatë profesionale, z. Preçi ka kryer një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vendit në lidhje me çështjet e auditimit të jashtëm në sektorin publik. Ai është pjesëmarrës dhe lektor në disa konferenca shkencore, si dhe ka publikuar një gamë të gjerë artikujsh në median e shkruar mbi auditimin, në dobi të mirëqeverisjes dhe mirëadministrimit të aseteve dhe pasurisë publike.



Kontakt

 gjpreci@klsh.org.al

 Rruga "Abdi Toptani", Tiranë
Shqipëri

 www.klsh.org.al